

## Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i Fjalimit të Xhumasë i Kalifit të V<sup>të</sup> të Xhematit Islamik Ahmedia,

**Hazret Mirza Masrur Ahmedit** mbajtur në Xhaminë Baitul Futuh të Londrës, më

# 12 janar 2007

Hazuri e filloi fjalimin e tij me recitimin e ajetit 275 të Sures Al Bakara: “**Al-ladhiina junfikuuna amvaalahum bil-laili wan-nahaari sirauwwa ‘alaa niatan falahum axhruhum ‘inda rabbihim wa laa khauufun ‘aleihim wa laa hum jahzanuun**”<sup>1</sup>. Ai pastaj vazhdoi duke thënë se sot do ta shpall vitin e ri të Vakfe Xhedidit<sup>2</sup>. Normalisht, shpallja e tij bëhet në xhumanë e parë të Janarit, por për shkak të turneut tim në Gjermani, vendosa ta shtyj shpalljen e tij deri në kthimin tim.

Projekti i Vakfe Xhedidit u themelua nga Hazret Musleh Maud<sup>ra</sup> - Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup>, në vitin 1957 dhe fillimisht i destinohej xhemateve në Pakistan. Nëse dikush jashtë Pakistanit, vullnetarisht dëshironte të merrte pjesë në të, lejohej, por ky apel nuk u drejtohej atyre. Që në fillim, si koordinator i projektit u emëruar Hazret Mirza Tahir Ahmedi (më vonë Kalif i Katërt i Xhematit) dhe u këshillua që të koncentrohej posaçërisht në dy gjëra: trajnimin shpirtëror të anëtarëve të xhemateve nëpër fshatra dhe së dyti aktivitetet në fushën e predikimit, e posaçërisht ndër hindusët e krahinës Sind, ku jetonte një numër relativisht i madh syresh.

Kalifi i Dytë<sup>ra</sup> ishte shumë i brengosur për faktin që anëtarët e Xhematit nëpër fshatra po ngecnin prapa në trajnimin e tyre fetar, e sidomos fëmijët. Një numër i madh i anëtarëve jetonte nëpër fshatra dhe nëse nuk do të merrnin trajnimin e nevojshëm religjioz, do të kishte probleme më vonë. Mirza Tahir Ahmedi<sup>ra</sup> kujton se, kur Kalifi i Dytë më emëroi në administratën e Vakfe Xhedidit, kërkoi nga unë që ta ekzaminoja plotësisht gjendjen aktuale të njohurive fetare nëpër fshatra. Që në fillim pashë se gjendja ishte alarmante. Fëmijët madje nuk dinin as gjërat më elementare siç ishte namazi. Edhe ato pjesë që i dinin i shqiptonin me shumë gabime, e madje disa nuk ishin në gjendje as ta recitonin shahadetin si duhet, pa të cilin njeriu nuk mund ta quaj veten mysliman.

<sup>1</sup> Ata të cilët e shpenzojnë pasurinë e tyre natën e ditën, fshehurazi e haptazi, shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre; dhe për ta s’do të ketë frikë e as pikëllim.

<sup>2</sup> Lloj kontributi monetar që paguhet vullnetarisht nga anëtarët e Xhematit Ahmedia.

Përgatitjet filluan menjëherë. U përgatitën listat e mësuesve që do të shërbenin nëpër këto fshatra të largëta, të cilët para nisjes pajiseshin me një trajnim elementar. Kjo ishte një ndërmarrje e vështirë, por me ndihmën e Allahut dhe me shumë përpjekje e sakrificë ata e bënë punën e tyre me sukses.

Hindusët e atjeshëm, për shkak të mungesës së shiut, endeshin nëpër vende më të pëlleshme të krahinës në kërkim të punës dhe për shkak të keqtrajtimit nga ana e myslimanëve, ata e urrenin edhe vetë emrin e Islamit. Ata ishin shumë të varfër, përkundër tokës që kishin, por që s' mund ta shfrytëzonin për shkak të mungesës së shiut. Myslimanët për të cilët punonin, i shfrytëzonin ata maksimalisht duke i paguar fare pak. Misionarët krishterë, duke parë se si po trajtoheshin, e shfrytëzuan varfërinë e tyre dhe filluan t'u jepnin ndihma duke i joshur në të njëjtën kohë drejt krishterimit.

Vakfe Xhedidi bëri një punë të madhe në atë rajon dhe ende është duke bërë dhe me ndihmën e Allahut, pas shumë vitesh përpjekje, ahmediati filloi të përhapej atje. Njëri prej vullnetarëve që kishte shërbyer atje, kujton se kur puna jonë filloi të jepte rezultatet e para dhe hindusët filluan ta pranonin ahmediatin, hoxhallarët filluan të shkonin te ta duke u thënë se ju jeni duke bërë një gabim të madh. Është më mirë të mbeteni hindusë se sa të bëheni ahmedianë. Në fakt, ajo që thoshin ishte se ishte më mirë për ta që të mbeteshin idhujtarë në adhurimin politeist të hinduizmit, se sa të kalonin në adhurimin e Një të Vetmit Zot. Por, sidoqoftë, Allahu i shpërbleu përpjekjet e tyre dhe Xhemati u themelua në krahinat T'har, Mit'hi dhe Nagarpak. Me ndihmën e Allahut ata u forcuan në sinqeritet, madje prej tyre dolën edhe të atillë që e dedikuan jetën e tyre në shërbim të Islamit dhe duke predikuar te populli i tyre e përhapën ahmediatin - Islamin e vërtetë. Ata vinin në Xhalsa Salanat në Rabwah dhe i shihja shumë të sinqertë, masha'allah.

Që në fillim, për shkak të mungesës së burimeve financiare, këta mësues të Vakfe Xhedidit që punuan në ato anë, bënë një jetë shumë të vështirë. Në mungesë të shërbimeve mjekësore në ato krahina, ata detyroheshin që për vete dhe për t'u ndihmuar të tjerëve, të mbanin me vete një koleksion të vogël medikamentesh. Tani, falë Zotit, Xhemati posedon farmaci lëvizëse që i vizitojnë fshatrat dhe ngrenë kampe medicinale që udhëhiqen nga ekipe të kualifikuara mjekësore. Atje Xhemati gjithashtu ka ndërtuar edhe një spital të syve. Në mbështetje të këtij projekti, ahmedianët në Pakistan, për trajnimin e tyre dhe për predikimin e mesazhit dhanë dhe ende janë duke dhënë sakrificë të mëdha. Elhamdulillah, tani aktivitetet janë zgjeruar shumë dhe puna ka ecur përpara dhe ashtu siç po e bekon Allahu Xhematin, rezultatet do të jenë gjithnjë e më të mëdha.

Po e shfrytëzoj rastin këtu që t'u them fermerëve ahmedianë të krahinës së Sindit, atë që u kishte thënë edhe Kalifi i Katërt, se hindusët e atjeshëm, apo ata që janë konvertuar në Islam, janë njerëz të varfër dhe për shkak të varfërisë së tyre enden në kërkim të punës. Ata janë shumë punëtorë. Ju duhet t'u ndihmoni atyre dhe të silleni mirë me ta, sepse do të jetë dashuria dhe mirësjellja juaj që do t'i sjellë më afër Xhematit. Atëherë edhe Allahu do t'i bekojë punën dhe përpjekjet tuaja.

Ua prezantova këtë historik të shkurtër të Vakfe Xhedidit, në mënyrë që të rinjtë dhe të konvertuarit të njihen me të. Tani ky projekt ka marrë karakter gjithëbotëror dhe kontributet mbledhen në të gjitha vendet e botës. Sa i përket Pakistanit, falë Zotit, ahmedianët e Pakistanit i përmbushin nevojat e veta dhe nuk kanë nevojë për ndihmë prej jashtë vendit. Më 1985 Kalifi i Katërt i dha Vakfe Xhedidit karakter gjithëbotëror, në mënyrë që ata ahmedianë që jetojnë në pjesë të ndryshme të botës, posaçërisht në Evropë dhe Amerikë, me kontributet e tyre të mund t'i ndihmojnë vendet si India dhe ta mundësojnë punën e tyre predikuese atje. Në kohët më të hershme në Indi pat marrë hov një fushatë e konvertimit të myslimanëve në hindusë e njohur me emrin "Lëvizja Shudi". Atëbotë, në kundër përgjigje Xhemati kishte bërë punë të madhe në pengimin e këtij konvertimi dhe në predikimin e Islamit ndër hindusët e atyre krahinave.

Më 1985, Kalifi i Katërt pat thënë se e njëjta situatë është e pranishme edhe tani në Indi dhe se diçka duhet bërë. Sa i përket shpenzimeve, ju do të ndihmoheni nga xhematet jashtë Indisë. Dhe kështu ky projekt u zgjerua edhe ndër xhematet e shteteve të tjera jashtë Indo-Pakistanit, në mënyrë që të ndihmohej Xhemati i Indisë në këtë detyrë fisnike. Xhematet e jashtme iu përgjigjen thirrjes për sakrificë financiare dhe Xhemati i Indisë iu përvesh punës.

Jemi dëshmitar të faktit se Xhemati është duke ecur me hapa të shpejtë drejtë progresit, prandaj edhe nevojat po rriten me shpejtësi. Allahu është duke na bekuar dhe duke i plotësuar nevojat tona, por edhe ne duhet të marrim pjesë sa më shumë në sakrificë që të bëhemi të denjë për bekimet e Tij. Falë Zotit, anëtarët e Xhematit janë bekuar shumë edhe si individë, prandaj duhet të jeni posaçërisht të vëmendshëm ndaj kontributeve të destinuara për xhematet e varfra. Ka xhemate të reja që janë themeluar në Indi e në Afrikë të cilat nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. Ata nuk janë koprracë, por mundësitë e tyre janë të kufizuara, prandaj na mbetet neve t'u ndihmojmë.

Xhematet e jashtme, posaçërisht ato të Vendeve të Perëndimit, valuta e të cilave është më e fortë, duhet të prijnë në sakrificat e tyre në shërbim të fesë dhe të shpërndarjes së mesazhit të saj. Allahu ka thënë që ata që sakrifikojnë në rrugën e Allahut do t'i fitojnë bekimet e Tij. Në ajetin që e recitova në fillim, Allahu thotë se ata që shpenzojnë në rrugë të Allahut natën e ditën, fshehurazi e haptazi, shpërblimi i tyre është tek Unë dhe të tillët nuk duhet të brengosen për nevojat e tyre personale. Ju kurrë nuk duhet të mendoni se duke shpenzuar në rrugën e Allahut, pasuria juaj do të pakësohet. Allahu thotë në ajete të tjera se ata që sakrifikojnë për Mua, unë do t'i shpërblej shtatëqind fish e më shumë. Prandaj, nuk ka vend për frikë e as për pikëllim.

Pra, secili ahmedian duhet të garojë me njëri tjetrin në sakrificë në rrugën e Allahut. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thotë se të shpenzuarit në rrugën e Allahut e forcon

besimin tuaj. Dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kërkon që hapat tanë gjithnjë të hidhen guximshëm në fushën e sakrificave financiare. Ngjashëm, edhe të konvertuarit e ri në vende të ndryshme nuk duhet të mendojnë se nevojat tona duhet të plotësohen nga xhematet e vendeve të tjera. Secili xhematë duhet të qëndrojë në këmbët e veta dhe t'i plotësoj vetë nevojat e veta. Në këtë kohë të avancimit, kur në njërin anë shohim një përparim të madh në fushën e zbulimeve shkencore dhe zhvillimin e teknologjisë, nga ana tjetër shohim një rënie të madhe të vlerave etike dhe morale. Për t'i shpëtuar fëmijët tuaj dhe për t'ia treguar botës rrugën e drejtë, nevojiten përpjekje të pareshtura. Është e qartë se për këtë detyrë fondet janë të nevojshme.

Ashtu si në kohën e Kalifit të Dytë, edhe sot nevojat për trajnimin e anëtarëve, e sidomos të të konvertuarve të rinj, janë shumë të mëdha. Kjo punë natyrisht që nuk mund të bëhet pa sakrificat tuaja. Është e vërtetë se me zgjerimin e punës, Allahu po i përmbush nevojat tona, por gjithmonë mund të bëhet edhe më shumë. Duhet të trajnojmë më shumë mësues dhe t'i dërgojmë gjithandej. Ka një numër të madh të vendeve afrikane dhe të krahinave në Indi që ende nuk kanë rrymë dhe ne duhet t'u sjellim rrymë atyre dhe t'u sjellim antena satelitore për ta shikuar MTA<sup>në</sup>, e cila është bërë një mjet i fuqishëm i predikimit. Ka edhe aktivitete të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të bëhen pa fondet e nevojshme.

Atyre që u besohet menaxhimi i fondeve të Xhematit, duhet gjithmonë ta kenë një gjë parasysh që secili cent i Xhematit duhet të shpenzohet si duhet dhe ku duhet. Shumica e këtyre fondeve vijnë nga anëtarët e varfër të Xhematit që bëjnë sakrifica të mëdha duke kontribuar, prandaj, në çdo nivel, administrata e Xhematit duhet të jetë syçelë se si shpenzohen këto para dhe gjithçka që shpenzohet të shpenzohet vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për t'i shërbyer njerëzimit. Përderisa do të shpenzojmë në këtë mënyrë, Allahu do ta bekojë punën tonë. Shpesh puna e Xhematit bekohet aq shumë nga Allahu sa që me 100 euro të shpenzuara bëjmë aq punë sa që organizatat e tjera nuk mund ta bëjnë as me mijëra euro. Pra, përderisa Xhemati do të shpenzojë me këtë kujdes edhe bekimet e Zotit do të jenë me ne.

Kur njeriu jep me motiv për ta ndihmuar çështjen e fesë, ai e ka marrë shpërblimin dhe nuk duhet ta lodhë më kokën se si do të shpenzohen paratë që i ka dhënë, me kujdes apo pa kujdes, me vend apo pa vend. Nëse ka ndonjë dobësi në mënyrën e shpenzimit, kontribuuesi do ta marr shpërblimin e tij gjithsesi. Prandaj, secili ahmedian, në zemrën e të cilit ka ndonjë hezitim, duhet ta largojë atë dhe të mundohet ta fitojë kënaqësinë e Allahut.

Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thotë se të gjitha qeveritë e botës funksionojnë me kontribute të mbledhura. E vetmja diferencë është se qeveritë i mbledhin me forcë tatimet, ndërsa te ne kjo është në ndërgjegjen e anëtarëve dhe pikërisht për këtë Allahu i shpërblen shumëfish sakrificat tuaja. Ai nuk i obligon robët e Tij me ndonjë

shumë të caktuar. Ai vetëm thotë se për çka do që shpenzoni do të shpërbleheni; i vetmi kusht është që të shpenzoni me qëllime të mira. Kjo është një tregti me Allahun dhe tregti më të mirë se kjo nuk ka.

Herën e fundit që e vizitova Kadijanin, e porosita Xhematin e Indisë që të bënin më shumë në fushën e trajnimit e të predikimit dhe këshillat e mia u morën seriozisht. Kjo shihet nga statistikave financiare që i kanë dërguar ku shihet një rritje e dukshme në kontributet e tyre. Kjo do të thotë se është punuar më shumë në trajnimin shpirtëror të anëtarëve e që ka rezultuar në shtimin e sakrificave të tyre financiare. Numri i kontribuuesve të Vakfe Xhedidit në Indi është rritur për 4000 dhe është hera e parë që i kanë tejkaluar premtimet e tyre për këtë vit. Ata kanë tubuar 230 000 rupi mbi buxhetin e premtuar, madje edhe në kontributet për anëtar kanë shënuar rritje. Siç thashë, numri më i madh i kontribuuesve janë të konvertuar të rinj ose që janë anëtarësuar para 3-4 vjetësh. Xhematet e Indisë, me kontributet e veta arrijnë t'i përmbushin vetëm 3% të nevojave të veta. Në Indi mundësia e rritjes së numrit të anëtarëve të ri është më e madhe dhe ata duhet të punojnë më shumë në këtë drejtim.

Siç e thashë më parë, Kalifi i Katërt (rahimahullahu aleih) e kishte shtrirë projektin e Tahrike Xhedidit në mbarë botën dhe arsyeja kryesore për këtë ishte që të ndihmoheshin xhematet e Indisë. Nga statistikave e patë se Xhemati i Indisë, nga burimet e veta arrin t'i përmbush vetëm 3% të nevojave të veta dhe 97% ndihmohet nga jashtë, posaçërisht nga Evropa dhe Amerika, ndërsa Afrika ndihmohet nga burime të tjera dhe jo nga Vakfe Xhedidi. Xhematet e shteteve të Perëndimit duhet t'u ndihmojnë Indisë dhe Afrikës dhe mund të bëjnë më shumë se deri tani. Justifikimi i tyre është se ata janë duke shpenzuar në fusha dhe sektorë të ndryshëm. Mirëpo të gjitha këto shpenzime ekstra janë edhe në Pakistan, porse atje niveli i sakrificës në Vakfe Xhedid viteve të fundit ka shënuar një rritje të dukshme. Në fakt sa më e vështirë që bëhet situata e ahmedianëve atje, aq më entuziastë po bëhen ata në sakrificat e tyre. Kjo është vërejtur edhe në vendet tjera, ku sa herë që Xhemati kalonte nëpër kohë të vështira, niveli i sakrificave shënonte rritje. Pra, ju në Vendet e Perëndimit nuk duhet të prisni që situata të vështirësohet, por duhet t'u ndihmoni vëllezërve tuaj.

Po flisja për kapacitetet në Vendet e Perëndimit. Së pari Kanadaja, e cila ka rreth 20-25 mijë anëtarë, ku shumica syresh janë me origjinë Indo-Pakistaneze. U them këtyre ahmedianëve se ju keni përgjegjësi ndaj Indisë sepse shumica prej jush i keni rrënjët nga India. Në Kanada numri i kontribuuesve të Vakfe Xhedidit është 4485. Pastaj vjen Gjermania e cila numëron përafërsisht 22500 kontribuues të Vakfe Xhedidit dhe ka kontribuar 15€ për kontribuues. Edhe në Gjermani shumica e ahmedianëve janë me origjinë pakistaneze. 15€ për kontribuues është pak për ta. SHBA<sup>të</sup> kanë kontribuar 137\$ për kontribuues. Kjo është mirë, por ata ende mund ta shtojnë numrin e kontribuuesve. Anglia ka kontribuar 34 Funta për kontribuues dhe numri i kontribuuesve është 12024. Edhe ata kanë kapacitet për

ta rritur numrin e kontribuuesve. Nuk duhet t'i harroni fëmijët të cilët duhet të inkurajohen t'i bashkëngjiten këtij kontributi.

Është e vërtetë që Allahu thotë se Ai nuk e ngarkon robin e tij mbi kapacitetet e tija, e ju duhet t'i përmbushni edhe nevojat tuaja familjare, por ju gjithashtu duhet të caktoni limite të shpenzimeve tuaja, përndryshe në këtë kohë nëse nuk i frenoni dëshirat dhe lakminë, oreksi për gjërat materiale vetëm sa vjen e shtohet. Ashtu siç thotë Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup>, për forcimin e besimit tuaj sakrificat janë të domosdoshme. Zhvillojeni shprehinë e të sakrifikuarit edhe te fëmijët tuaj, kështu që kur të rriten, ta bëjnë të sakrifikuarit në rrugën e Allahut qëllimin parësor të jetës së tyre. Kur t'u jepni fëmijëve tuaj paratë e xhepit, këshilloni që nga ajo që u keni dhënë, të paguajnë pjesën që i takon Allahut.

Vitin që e lamë pas janë grumbulluar 2.2 milion Funta, që krahasuar me vitin e kaluar është më e lartë për 83 mijë Funta. Në vendin e parë është Pakistani. Zakonisht Amerika e ka mbajtur vendin e parë, por për shkak të devalvimit të dollarit, këtë vit kanë ngelur në vendin e dytë. Në Pakistan, niveli i sakrificës viteve të fundit është duke u rritur. U them ahmedianëve të Pakistanit që tani që e keni ngritur nivelin e sakrificave, mos lejoni të bie përsëri dhe çdo opozitë dhe vështirësi duhet vetëm ta rris pasionin tuaj të sakrificave. Britania është në vendin e tretë, pastaj është Gjermania, Kanadaja, India, Indonezia, Belgjika, Australia, Zvicra, Franca e kështu me radhë. Në Francë anëtarët janë duke bërë një punë të mirë në predikimin e mesazhit. Ata kanë predikuar gjithashtu edhe në disa ishuj të afërt dhe kanë pasur rezultate të mira. Tani ata duhet të përpiqen që ta rrisin edhe numrin e kontribuuesve.

Sa i përket numrit të kontribuuesve, këtë vit ai është më i madh se 492 000 dhe është për 26 700 më i lartë se në vitin paraprak. Allahu i bekoftë të gjithë ahmedianët, të cilët duke e lënë veten keq kanë sakrifikuar për hir të Allahut. Allahu e shtoftë dhe e bekoftë pasurinë e tyre. Secili ahmedian duhet ta di se për të fituar bekimet e veçanta të Allahut ai duhet të mundohet të prijë në sakrificat në rrugën e Allahut. Xhemati është i angazhuar në projekte të ndryshme dhe ju nuk duhet të kontribuoni vetëm në njërin prej tyre duke i injoruar të tjerat. Kurrë mos lejoni që mendime të tilla t'u vinë vërdallë në kokë. Ta dini se në jetën tjetër pasuria më e mirë do të jetë ajo që e keni sakrifikuar në rrugën e Allahut.

Në këtë kohë, anëtarët e të gjitha xhemeve të botës janë duke i kushtuar shumë rëndësi ndërtimit të xhamive. Angazhimi juaj në projekte të tjera nuk duhet të bëhet pengesë për ndërtimin e xhamive. Ju duhet t'i çoni gjërat paralel. Xhemati i Britanisë së Madhe është zotuar që për çdo vit të ndërtojë pesë xhami. Në Bredford ka filluar ndërtimi i një xhamie dhe përgatitjet po bëhen që së shpejti punimet të fillojnë edhe në dy qytete të tjera. Pra, projekte të ndryshme duhet të shtyhen përpara, krahas njëra-tjetrës. Xhamitë janë një mjet i fuqishëm i trajnimit shpirtëror si dhe i predikimit. Në njërin nga tubimet e grave të Xhematit, ato kërkuan me forcë që në disa qytete të ndërtohen xhami, sepse po kanë probleme me edukimin e fëmijëve. Unë u thashë atyre se askush nuk mund ta mohoj se

xhamitë janë të domosdoshme, por ju duhet t'i ndërtoni vetë ato. Askush s'do të vij nga jashtë e t'i ndërtoj ato për ju.

Gjatë vizitës sime në Gjermani, elhamdulillah, i inaugurova 3 xhami dhe e vura gur themelin e një tjetre. Njëra nga xhamitë që i inaugurova ndodhet fare pranë kufirit të Holandës. Në fakt ajo nuk ishte ende e kompletuar plotësisht, por anëtarët e atyshëm shprehën dëshirën që të faleshim atje dhe të bënim një dua dhe këtë ata do ta llogarisin si inaugurim. Insha'allah së shpejti ajo do të kompletohet. Ajo është një Xhami madhështore e ndërtuar nga "Mexhliis Ansarullah"<sup>3</sup> në të cilën mund të falen 780 adhurues dhe tani për tani, kjo është xhamia më e madhe në Gjermani. Në kuadrin e saj është edhe një Shtëpi Misioni me zyrat e nevojshme dhe një bujtinë.

Siç e dini ju të gjithë, sukcesi më i madh i turneut tim në Gjermani ishte vënia e gur themelit të Xhamisë së Berlinit. Opozita atje është shumë e fortë, madje edhe tani opozitarët zotohen se nuk do ta lënë xhaminë të ndërtohet. Ndihma e Allahut është me ne në çdo hap dhe këtë po e shohim vazhdimisht. Në fillim Amiri i Gjermanisë dëshironte që të shkoja atje më herët për të vënë gur themelin, por unë vendosa që të shkoja në dhjetor. Edhe ashtu, deri atëherë ata nuk e kishin marrë lejen e ndërtimit me shkrim, të cilën e morën vetëm pas arritjes sime atje. Pas marrjes së saj, nuk mbeti më ndonjë pengesë legale; përndryshe do të mund të kishin ndodhur gjëra të pakëndshme dhe nuk do të kishte qenë e mundur të vihej gur themeli. Gjatë ceremonisë së vënies së gur themelit ishin të pranishëm edhe Kryetari i Komunës me një anëtar të Parlamentit lokal, të cilët i mirëpritën mesimet e Xhematit dhe shprehën dëshirën që të gjitha problemet tona të tejkaloheshin.

Në rrugë kishin dalë një turmë kundërshtarësh prej përafërsisht 40-50 veta që brohorisnin parulla kundër ndërtimit të Xhamisë. Kjo nuk na habiti, sepse një gjë të tillë e prisnim, por na habiti paraqitja e një grupi tjetër të cilët në dorë mbanin mbishkrime në mbështetje të ndërtimit të Xhamisë dhe në mbrojtje të Xhematit. Xhemati nuk kishte ditur asgjë për këtë grup tjetër që do të ngrihej në mbrojtjen tonë, por Allahu vetë e kishte organizuar një gjë të tillë. 2-3 qytetarë u munduan t'ua rrëmbenin flamujt me mbishkrime antiahmediane palës kundërshtare. Allahu vetë e kishte organizuar dhe ne nuk patëm nevojë të bënim asgjë, sepse vetë njerëzit e tyre i ndalonin.

Anëtari i Parlamentit Lokal që mori pjesë në ceremoni, ishte i mahnitur me pikëpamjet e Xhematit tonë dhe tha se nuk mund ta kuptonte se si njerëzit mund ta kundërshtonin ndërtimin e Xhamisë së një Xhematit kaq paqësor. Gazetat dhe televizioni e mbuluan mirë ngjarjen. Siç e kam përmendur edhe në fjalimin tim në Gjermani, Kalifi i dytë në kohën e tij kishte pasur një dëshirë të madhe për ta ndërtuar një xhami në Berlin dhe veç sa se kishin blerë një gjysmë hektari tokë

---

<sup>3</sup> Organizatë brenda Xhematit e anëtarëve më të vjetër se 40 vjet.

atje. Tani është e vështirë të blihet një truall kaq i madh, sepse toka është shumë e shtrenjtë. Trojet që i blejmë në Gjermani për ndërtimin e xhamive janë zakonisht të vogla, por me ndihmën e Allahut, truallin që e blemë për Xhaminë e Berlinit është më i madh se një gjysmë hektari, madje Allahu na ka mundësuar ta blejmë me një çmim shumë të volitshëm.

Më 1923 kur Kalifi i Dytë kishte apeluar për ngritjen e fondeve, gratë e Xhematit i kishin tubuar ato fonde. Musleh Maud<sup>ra 4)</sup> tha atëbotë se evropianët mendojnë se ne i trajtojmë gratë si kafshë, por kur të dëgjojnë se qendra fetare do të ndërtohet me fondet e mbledhura prej tyre, do të ndjehen të turpëruar. Kur gratë e xhematit të Gjermanisë e morën vesh se përpjekjet e para ishin bërë nga gratë e Kadijanit e të Indisë, ato thanë se ne do të kujdesemi kësaj here për tubimin e fondeve për këtë Xhami. Kjo do të kushtoj 1.5-2 milion euro. Allahu u ndihmoi atyre që sa më shpejt të mund t'i plotësojnë premtimet e tyre. Emri i kësaj xhamie do të jetë Hadixha. Gratë e Xhematit duhet gjithmonë ta kujtojnë se ky emër i bekuar është emri i asaj gruaje fisnike që e para besoi në Profetin e Shenjtë<sup>sas</sup> të Islamit dhe e sakrifikoi gjithë pasurinë e saj në rrugën e Allahut.

Kjo xhami në Berlin është xhamia e parë në Gjermaninë Lindore dhe insha'allah do të ndërtojmë edhe shumë xhami të tjera ku do të lartësohet emri i Një të Vetmit Zot. Ne jemi ndihmës të Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup>, misioni i të cilit është lartësimi i emrit të Allahut në të gjitha skajet e tokës. Allahu na mundësoftë ta shohim sa më shpejtë atë ditë kur e gjithë bota, të mbledhur rreth flamurit të Muhamedit<sup>sas</sup> do ta adhurojë Një të Vetmit Zot. Amin!

**Note:**

This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of 12 January 2007 held in 'Baitul Futuh' Mosque - London, UK. The main topic of this Khutba is **The anouncement of the new year of Waqfe Jadeed and sacrifices in the way of Allah**. This translation has been prepared by the members of Kosovo Jama'at

---

<sup>4</sup> Emri me të cilin shpesh referohet Kalifi i Dytë i Xhematit Ahmedia dhe që do të thotë Reformatori i premtuar.